

Legjenda dhe Historia e Norës dhe Kelmendit

Ky shkrim është një model i studimit kërkimor sirdanik

Historiografët ajojnë kah aftsitë luftarake të Norës së Kelmendit, kurse legjendat anojnë kah bukuria e mahnitëshme. Të dyja sëbashku formulojnë narrativën e një heroine me aftsi të jashtëzakonshme luftarake dhe me bukuri të rallë. Megjithatë, e vërteta rreth norës nuk mund të shpëputet prej bashksisë ku ajo u lind, u rrit, dhe u edukua si person dhe si luftëtare, dhe u stërvit si luftëtare, Kelmendit të para 400 vjetëve.

Narrativi rreth Norës lidhet ngushtazi me legjendat dhe me kushtet, konditat, e parimet e bashksisë në të cilën ajo u lind, u rrit dhe u edukua si përsone e si luftëtare, Kelmendit. Prandaj, e vërteta rreth saj nuk mund të shpëputet as prej legjendave as prej historisë së Kelmendit; veçsisht prej luftës së Kelmendit kundër otomanëve rreth vitit 1640 në të cilën ajo mori pjesë

Por, Kelmendi i shekujve 17^{te} e 18^{te} ishte një bashksi që sot është e vështirë të imagjinohet. Natyra e pasun e Alpeve u mundsonte atyne një jetë relativisht të pasun, por ata kishin edhe një burim tjetër pasunie, prëtimin mbë karavanet otomane, dhe tregtarët serbë, boshnjakë, e shqiptarë. Ndryshe prej shumicës së ballkanasve të perëndimit, të kishin pranum fenë dhe ligjin e pushtuesit, ose ishin vakufë, kelmendasit ishin të lirë. Përpjekjet e pashave shqiptarë me e pushtua këtë bashksi në emën të otomanëve kishin përfundum me turp.

Paraqitja

Nora e Kelmendit, Tringa e Grudës, Nora e Hotit, dhe Dranja e Kelmendit ishin katër femëna që u patën përballun me dhunën e mashkujve gjysmë të civilizum në perioda të ndryshme të historisë së Lekëve. E para vrau një pashë anadollak sepse ai donte ta merrte atë për grua me dhunë, e dyta luftoi kundër malazezëve, e treta luftoi kundër askjerëve, nizamëve e bashibazukëve otomanë e vendas, dhe e katërta vrau një cub që e pati përdhunuom.

Heroizmi i tyne ishte i mundun sepse ato u patën rritun në një

bashksí që anglohej në parimin *primus inter pares* (lit. i parë në mes të njinjitëve). Vetëm në një sistem të tillë, të bazuom në meritokrací, mund të ushqehet një heroizëm i tillë; ai do të kishte qenë i pamundun në një shoqni të pacivilizuome ku gratë trajtoheshin si robina.

Sipas historianëve, rreth vitit 1640, Kelmendi pati bamë një luftë jashtzakonisht heroike kundër otomanëve. Në këtë përballje, numri i kelmendasve ishte 1,200 luftëtarë; 900 mashkuj e 300 femëna. Në varsi prej historianit a shkollarit, numëri i ushtarëve otomanë jepet diku në mes 12,000 e 30,000 ushtarë e bashibazukë, në përbamjen e të cilëve kishte ballkanas muslimanë, laramanë, kristianë, të huaj prej Lindjes së Mesëme, Azisë, e Afrikës.

Beteja vendimtare e kësaj lufte, dhe luftëtarja adoleshente që vrau pashën, u patën përjetsua në shumë shkrime historike e legjenda. Zani i tyre arriti jo vetëm në Ballkanin e sunduom prej otomanëve, por edhe në perëndim.

Pëmbledhja Letrare

Tekstet që u patën shkruom në shekullin e Norës mund të ndahen në dy kategori, *Relacione* shkruom prej priftënish që e kishin për detyrë t'i reportonin Vatikanit rreth gjenjes së katolikëve shqiptarë, dhe *trajtime historike* shkruom prej historianësh a shkollarësh. Ka mundsi që disa prej këtyne teksteve të jenë shkruom dekada më vonë, prandaj ato mund të jenë ndikuom edhe prej legjendave që kishin marrun formë rreth Norës dhe fisit të Kelmendit.

Në shekullin e njëzetë, Marin Sirdani pati shkruom një artikull të zgjanuom rreth Norës dhe Luftës së Kelmendit, ku ai citonte shumicën e autorëve të herëshëm, por ku mungojnë citimet prej *Relacioneve*. Me komplementua historinë me legjendat popullore, ai intervistoi dy vetë, të cilët, ai argumenton u patë zgjedhun për thellsinë e ditunisë së tyre.

Deri tash, nuk ka monografi as për Norën as për Luftën e Kelmendit të vitit 1640. Por, këtu duhet qartësua përkufizimi i termit ‘monografi’. Monografi quhet një tekst rreth një subjekti të specializuom, tipikisht një volum i shkruom prej një autori. Monografitë janë shumë të randsishëme për shkollarët sepse në to gjinden referencat e autorëve më autoritarë. Për shembull, mund të thohet që vepra e Gjergj Nikprëlës për luftën e Mbishkodrës është një monografi sepse në këtë tekst gjinden referencat shumë të randsishëme. Në anën tjetër, ta titullosh një tekst ‘monografi’ nuk e ban atë të tillë.

Burimi tjetër rreth Norës dhe Luftës së Kelmendit të vitit 1640 gjindet në lirikat e lahutareve. Ndryshe prej shkrimeve të masipërme, këto lirika përmbushnin nevojat shpirtnore të bashksisë që i krijoi e zhvilloi ato.

Mungojnë kerkimet arkeologjike rreth *Qytezës së Kelmendit* në Nikç, dhe banimit të saj në vitin 1640. Mungojnë edhe gjetje të artefakteve të Norës, p.sh., kurtjeli ose shpata me të cilën ajo vrau pashën, gunleta (xhubletë vajzash) e Norës, dhe ndonjë artefakt tjetër.

Tematikusht, kjo përmbledhje letrare mund të ndahet në dy kategori: 1) në burime që e shohin Norën si një luftëtare shumë të aftë, e cila merrte pjesë në sulme kundër ushtrisë otomane dhe në plaçkitjen e karavaneve otomane, dhe tregtarëve serbë, boshnjakë, dhe shqiptarë, dhe 2) si një vajzë të cilën Vuçi pasha cakonte ta merrte për grua; me dëshirë a me dhunë.

Në të dyja rrefimet, Nora paraqitet si një adoleshente me bukurí të mahnitëshme. Marini shkruan që ajo njihet si *Nora e Bukur*. (Megjithatë, ai e titullon shkrimin e tij *Judita e Kelmendit* ??).

Në temën e parë trajtohet trimnia e shkathtsia luftarake e Norës, kurse në temën e dytë, trajtohet lufta për nder. Në të dyja temat,

Nora paraqitet si një heroinë sepse ajo vret përbindëshin që rrezikonte edhe egzistencën fizike edhe esencën shpirtnore të bashksisë. Me veprën e saj, Nora u ofroi femënave e mashkujve shqiptarë mësimin e thjeshtë të luftëtarit a luftëtares: *Vjen një kohë kur dhuna dubet luftua me dhunë; kur njeriu përballlet me çastje që janë më të randsishëme se jeta.*

Metodologjia

Në këtë shkrim, historia shihet si subjektive dhe interpretative; si e ndërtuome prej një bashksie, por jo e ndërtuome në kuptimin e fantazisë. Kelmendasit e ndërtuan historinë e tyre me anë të bamave të tyre, të cilat janë faktet; dhe me anë të legjendave, të cilat tregojnë vlerat që kelmendasit vendosnin në këto fakte. Ishte mbë këto *fakte e vlera* që kelmendasit e mbështetnin *politikën* e tyre të pamvarsisë e mosënshtimit.

Këtu është zgjedhun metoda sirdanike, një metodë eklektike e përshtatëshme për historicitetin e një bashksie, ku *arkeologjia, gjuha, e historiografia* përballen me *legjendat*; secila anë duke shërbye si kontrolluese ndaj anës tjetër.

Për këtë tekst, informacioni është mbledhun prej teksteve ku jepen citime prej historianësh e shkollarësh të shekujve 17^{të}, 18^{të}, dhe 20^{të}. Në shkrimin e Sirdanit janë përfshimë edhe dy intervista, por të cilat autori i pati shkrimë me studimin e tij; nuk gjinden të veçuome. Ndoshta ato ishin pjesë e 2,000 faqeve që komunistët ia patën djegun Marinit.

Metodat

Me cak me paraqitë një pikpamje që nuk anon as kah historiografia as kah legjendat, ky tekst bazohet në leximin dhe analizimin e teksteve të shkruome prej shkollarëve dhe në legjendat që tregohen në lirikat e lahutarëve e rrëfimeve popullore. Qëllimi i kësaj përballieje është me nxjerrë një narrativ më të plotë, më të thellë, e

mâ të balancuom; një narrativ që merr parasysh si nevojat informative të akademikëve si nevojat psikologjike të bashksisë.

Kontrolli e Balanca

Legjendat tregojnë nevojat psikologjike të krijuesve të tyre. Ato dëshmojnë për rreziqet që kërcënojnë bashksinë dhe heronjtë që përballen me këto rreziqe. Njëni prej rreziqeve të kohës së Errsinës Ballkanike ishte dhunimi i femënave. Kjo situatë kërkonte heronj të gatëshëm me rrezikua jetën e tyre. Por, ndryshe prej shumicës së kulturave botnore, ku âsht i dashuni i femënes ai që e mbron atë prej përbindëshit fizik a psikologjik, në legjendën 400 vjeçare të Kelmendit âsht vetë femëna, Nora, ajo që mbron vetveten.

Legjendat

Sipas legjendave besohet që i ati i Norës quhej Vok. Ai ishte prej Selcet, dhe trashëgonte titullin Vojvodë. Kjo tregon që Nora vinte prej parisë së Kelmendit.

Voku u pat martuom me Hanën. Kur Hana vuni re që ata do të shtoheshin me një fëmijë, ajo i tregoi Vokut. Thohet që Hana *iu lut Orës* që Ajo t'u jepte atyne një djalë, veçsisht sepse pak kohë mâ parë bashkshortëve u kishte vdekun një djalë rreth pes vjeç. Kurse Voku iu lut Orës edhe për arsye të tjera. Ai dëshironte që i biri i tij të bâhej luftëtar dhe të trashëgonte titullin e Vojvodës.

Në vend të djalit, Ora u dhantoi Vokut e Hanës një vajzë, Norën. Ashtu si në dramën e Sofokliut, edhe në rrëfimin e Norës së Kelmendit thohet që, në një buznatë, Voku e la foshnjen në mal; ushqim për bishat. Por një emtë e Norës, ndoshta duke e ditë qëllimin e Vokut, e mori mbesën e saj dhe e rriti atë si të vetën. Sipas Marin Sirdanit, Nora ishte një adoleshente e pamartuome. Në fakt, vetë fakti që pasha cakonte ta merrte atë për grua tregon që ajo ishte e pamartuome.

Kjo është legjenda që ka mbetun në rrëfimet e Kelmendit, por edhe të Nënshkodrës, Mbishkodrës, Vuthajve, Martinajve, Rugovës, dhe zonave të tjera ku jetojnë Lekët.

Prej këtyre legjendave mund të inferojmë që Nora ishte fëmijë i padëshiruom. Ky koncept është pagan, jo monoteist. Edhe lanja e fëmijës në mal forcon asertën që kelmendasit e asaj kohe ende praktikonin paganizmin. Kështu, kelmendasit shfaqnin tri aspekte pagane: 1) lutjet ndaj Orës, 2) përzgjedhjen e fëmijëve gjenetikisht të shëndetëshëm ose të dëshirueshëm, dhe 3) prëtimin; 400 vjet pas Vikingëve. Ka gjasë që Kelmendasit të ishin populli i fundit që konvertoi në fenë kristiane.

Ky konvertim pati ndodhun para emigrimit të kelmendasve në Rugovë, Vuthaj, Martinaj, dhe zonat e Plavës e Gucisë; domethanë, këta të fundit konvertuan në fenë islame prej kristianizmit, jo paganizmit. Por, *konvertimet në monoteizëm nuk arritën kurr t'i shuanin ritet e besimet pagane as në këtë bashkësi as në bashkësitë tjera të malsive të veriut* (M. Sirdani, *Kontribut*).

Këtu duhet cekë që feja e kultura janë të ndryshme prej njëna-tjetrës. Kristianizmi e islami janë fe monoteiste, kurse kultura e shqiptarëve është greko-romake-europjane. Feja bazohet në besim (en. faith), kurse kultura jonë bazohet në arsytim (en. logos). Prandaj, morali i monoteistëve është besimtar/jobesimtar, kurse morali shekullar i perëndimit është racional/joracional; ose i kulturuom i pakulturuom.

Nuk ka dokumente të shkruome që tregojnë kohën egzak të konvertimit të shqiptarëve, por ka legjenda. Për shembull, thohet që rugovasit konvertuan prej në kristianizëm në islam sepse ata nuk kishin prift katolik; atyne u nevojitej një ndërmjetës me zotin. Ky shembull tregon që legjendat nuk mund të zëvendsohen prej informacionit. Data kur rugovasit konvertuan në fenë islame nuk tregon ndonjë gjë të randsishme. Kurse nevoja që ata kishin për

një ndërmjetës në mes tyre dhe zotit të tyre monoteist, tregon një nevojë psikologjike, ndoshta universale.

Është e randsishme me ndjekë kronologjinë e konvertimit të disa kelmendasve: pagan, > kristian > musliman, sepse kështu mund të njihemi me Norën e Kelmendit, dhe të pyesim nëse ajo ishte Pagane apo Kristiane. Në qoftë se dikush do të përpiquej me gjetë artifaktet e Norës, ai ose ajo do të duhej t'i kërkojë ato jo vetëm ndër kristianë por edhe ndër muslimanë: prej Shtojit të Rí në Podgoricë, prej Vuthajve në Rugovë, dhe përgjatë bregut të Adriatikut, prej derdhjes së Matit te derdhja e Bunës. Nuk dihet se ku përfunduan pasardhësit e Nores, as nëse sot ata janë paganë, kristianë, muslimanë, apo ateistë.

Vuçi Pasha, si përfaqësues i pushtuesit që kishte vramë, premë, dhunuom, e përdhunuom në të gjithë Ballkanin e asaj kohe, u jep kelmendasve një dilemë në formë ultimatum: *Më jepni Norën për grua, ose pranoni dëgjien e Kelmendit*. Kjo legjendë e gjen shkakun e luftës kelmend-otoman aty ku grekët patën gjetun shkakun e luftës grek-frigjian; te bukuria e rrallë e një femëne. Ndryshimi është që ndërsa Helena iku me Parisin, Nora e vrau pashën. Pa dashtë me kalua në tribalizëm, Nora ishte spartane; jo Helena.

Në shenimin 767, faqe 456, Marin Sirdani shkruan që shkrimi i tij rreth Norës u pat komplementuom prej dy intervistash, njëna prej Prel Tom Cubit, Vojvodë i Selcës, dhe tjetra prej Gjet Alezi, burrë në shenj prej Boget. Këto intervista pohojnë që ndikimi i Norës vazhdonte të ndjehej ndër Lekë edhe në fillim të shekullit të njëzetë; legjenda vazhdonte të përmbushëte nevojat psikologjike të bashksisë. Në fakt, ishte në atë kohë që Dranja e Kelmendit pati vramë një cub¹ që e pati përdhunuom.

¹ cub – sipas Gjeçovit, cub quhet ai që vjedhë kafshë shtëpiake.

Legjendat rreth Norës dallohen prej historiografisë edhe në një pikë tjetër. Sipas legjendave Nora e mbyti pashën me anë të kurtjelit² të saj, dhe ishte vetëm për vetëm me të. Kurse, sipas historisë, ajo ia preu pashës kryet me shpatë, dhe ishte pjesë e një ushtrie. Kjo mund të duket si një detaje e vogël, por ajo tregon dy pikvështrime të ndryshme. Legjenda përqëndrohet në përballjen emocionale. Mund të thohet që ajo e redukton idenë e lirisë e nderit në një shpërthim momental emocional. Kurse historia, duke e pá luftën si një pejsazh dhe heroinën a heroin si një pikë në këtë pejsazh, i redukton nevojat shpirtnore të një bashksie në një deklaratë argumentative, në një datë historike, dhe në arithmetikën e numërit të ushtarëve të vdekun e të gjallë.

Historiografia

Historiografia rreth Norës dhe Luftës së Kelmendit ka dy burime: 1) Relacionet rreth gjendjes së katolikëve shqiptarë të cilat priftënit katolikë ia dërgonin Vatikanit, dhe 2) Shkrimet prej historianëve e shkollarëve, të cilat egzistojnë në vepra të veçanta.

Relacionet

Me anë të *Relacioneve*³ priftënit katolikë në Shqipëri njoftonin Vatikanin rreth gjendjes së katolikëve shqiptarë nën sundin ushtrisë muslimane që kishte pushtuom vendin. Në njënin prej këtyne relacioneve shkruhet:

Të gjithë të tjerët të maleve kanë bamë paqe me turqit, d.m.th. Gashi, Iballja, Mirdita dhe vende të tjera, përveç Pultit e Kelmendit. Tash sulltani ka dërgue një pashë me 20 mijë ushtarë, dhe ka mbledhë edhe të gjithë të krishtenët e

² Thikë me dy tehe që u jepej vajzave Leka në moshën 13 vjeçe. Tipikisht, këto vajza veshnin një gunletë (xhubletë e lehtë), dhe thikën e mbanin me vete pas postavës. Qëllimi i armatosjes së këtyne vajzave ishte me mbrojtë nderin, por mund të argumentohet që ato e mbanin kurtjelin edhe prej rrezikut të sulmeve prej ushtrisë otomane, e cila e kishte për traditë me dhunua femënat.

³ (*Relacione mbi Gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në Shekullin XVII, Vëllimi II (1634-1650)*), Faqe 129-31)

musulmanët e këtyne fushave, dhe kanë shkue kundër kelmendasve Këta nuk e dinin se do t'u shkonte ushtëri sepse një shtrigë⁴ i gënjeu. Asgiamangut, sapo e morën vesh se shkonte një ushtri e tillë kundër tyne--dhe ata nuk ishin veçse nantqind luftarë - menjëherë... kanë vramë kaq turq dhe skizmatikë t'ushtrisë së turkent, sa pothuej një gjysmë dite ecëshe nepër kufomat e të vdekunve, dhe prej tyne [Kelmendasve] nuk kanë mbetë veçse 10 të vdekun e 4 të plagosun.

Autori vazhdon:

Pultianët e thanun rrijnë ndër male shumë të thepisuna, dhe bahen shumë (?), por të vorfën; kanë dy priftën, por dysboj se mos janë si ndonjeni prej tyne; ijedhin, vrasin, e bajnë skllavë dhe plaçkisin turqit, skizmatikët dhe të krishtenët, dhe thonë se këtë e bajnë për nevojë, mbasi turqit i plaçkisin. Kelmendasit janë në kufi [me Pultin], por në një malsi ma të fortë dhe prandaj janë të pamposhtun; janë ma të fortë se Pultianët dhe ma të pasun, por ma t'egjër⁵, sepse rrallë herë shkon prift te ta. Me emën janë të krishtenë, por me vepra aspak;... Kaq shumë u ka dalë zani e kaq të mëdha janë pretimet⁶ e tyne dhe damet që bajnë, saqë shpesh herë sultani ka dërgue ushtri kundër tyne e pultianëve, por kurr s'kanë bamë asja.

Më 3 Gusht 1707, V. Zmjaviqi i shkruan Vatikanit:

“Dí se midis Kelmendasve u dukën në betejë 300 gra, të armatosuna me çdo gjá, kurse njëna prej tyne, pati nderin me vrá e me i pré kryet komandantit të ushtrisë otomane, në korrik të këtij viti.”

Ky relacion i shkruom rreth 70 vjet pas luftës së Kelmendit e paraqet përballjen e Norës me pashën si pjesë e luftës së kelmendasëve me otomanët, ku Nora i pret kryet pashës me shpatë. Këtu, caku i autorit është me tregua që Nora ishte luftëtare e stërvitun. Tregimi i këtij autori përkon me atë të

⁴ shtrigë – Koncepti ‘shtrigë’ në fetë monoteiste është koncept paragjykses. Ajo që ata qajn ‘shtrigë’ në fenë pagane quhet Dijetare (Orakull).

⁵ ‘të egjër’ – Këtu, kjo fjalë nuk ka as kuptimin të pazhvilluom as më të trima ose guximtarë. Autori, një prift katolik, njësion paganizmin me pazhvillimin dhe kristianizmin me zhvillimin. Kështu, ‘má të egjër’ domethanë ‘má të pakristianizumu’. Krahaso, Pulti kishte dy priftën, kurse Kelmendi asnjë.

⁶ ploja, plaçkitja, piratnia; grabitja e karavaneve otomane

Sirdanit, ku esenca e Norës është luftëtarja e jashtzakonëshme.

Në *Relacione* 159-61, shkruhet:

Kelmendasit banojnë ndër male shumë të mëdha dhe me pozita të forta [?] ndërmjet Bosnjës dhe Shqipnisë. At janë me kombësi shqiptare, flasin shqip dhe janë të përfshimë ndër kufijt e Shqipnisë, ushtrojnë besimin tonë të shenjtë katolik romak, por prej mungesës së punëtorëve⁽¹⁶⁾ janë shumë injorantë ndaj këtij besimi të shenjtë⁷. Janë afro 250 shtëpi dhe 2900 frymë. Janë shumë të egër prej natyre dhe shumë të guximshëm në mjeshtërinë ushtarake, të pashëm, dhe trupmëdhaj. Kështuqë kur sulltani vuni nën zgjedhje të gjithë Shqipninë, Bosnjën, e Sërbinë që janë krabina për rreth këtyne popujve të Kelmendit, kurr nuk muji me ia shtrure vullnetit dhe bindjes së vet këta dhe disa popuj të tjerë banorë të maleve të Dukagjinit... Këta popujt e Kelmendit janë edhe shumë të pasun sepse përherë nëpër Shqipni, Bosnje e Serbi kanë plaçkitë e grabitë tregtarët e këtyne tri krabinave tue marrë çdo vjetë, ma shumë o ma pak, 40-50 kuaj të ngarkuem.... ma se një herë janë shtrimë edhe në Bosnje me plaçkitë fshatënat në mes të ditës, me marrë skllavën, kafshë, orendi argjanti dhe plaçka shtëpiake. Kjo shkaktoi që disa veta nga këto 3 krabina, dhe sidomos ata të Bosnjes, vajtën në Stamboll me u ankue dhe me i r'a ndër kambë sulltanit kundër Kelmendasve për kaq fyemje, tue i thanë se në qoftë se nuk do të merrej ndonjë masë që me i rrenue Kelmendasit kryengritës dhe që na bajnë keq, na që jemi shtatatis tuej dhe ju paguejmë kaq shumë haraç, dhe ju sjellm kaq shumë shërbime, nuk mund t'i durojmë shtypjet e tyre dhe prandaj do të detyrohemi me ikë në shtete të krishtena me të gjithë familjen, me fshat e me mbarë krabinën... sulltani u idhnue mjaft kundër Kelmendasve... [ai vendosi] të merrej me rrënimin e Kelmendit.

Interesant është që në këto grabitje Kelmendasit, ashtu si Pultianët, grabitnin edhe sklleven, të cilët ata ose duhej t'i

⁷ 'inJORantë ndaj këti besimi të shenjtë' - Këtu argumentohet që kelmendasit nuk e njihnin (inJORantë – mungesë dieje për diçka) besimin kristian. Fakti që ende në shekullin e njëzetë besohej në Orë, Zana, e Shtojzovalle, tregon që në atë kohë, kelmendasit praktikonin fenë pagane. Në anën tjetër, prifti që shkruan këto relacione ishte injorant ndaj paganizmit.

mbanin në shtëpitë e tyre ose t'i shitnin. Ky aspekt nuk trajtohet në historinë e Shqipnisë.

Në faqen 181 të *Relacione*, autori shkruan që Kelmendasit ishin të detyruar me i mëshfë personat në “seksin femnor”. Kështu, mund të inferohet që ushtria otomane përdhunonte ose grabiste grá e vajza në vendet që ajo pushtuome.

Historianët

Këta autorë nuk ishin prezent as në Luftën e Kelmendit as në vrasjen e pashës, dhe nuk jetonin në verí të Shqipnisë në kohën e ngjarjeve që ata përshkruajn. Mundet që ata nuk patën ramë në kontakt as me ndonjë person që i kishte dëshmuar këto ngjarje me sytë e tij ose të saj.

Autorët kryesorë që patën shkruar për Norën dhe Luftën e Kelmendit ishin Pjetër Bogdani dhe teologu italian Arcangelo da Salto. Ka gjasë që François Lenromantit dhe Enrico de Gubernatis citojnë da Salton. Marin Sirdani i citon të katër shkollarët.

Kështu, historia e Norës dhe Luftës së Kelmendit ka dy autorë kryesorë, Bogdanin dhe da Salton. Të dy ishin autoritete akademike të njohura të kohës së tyre. Prandaj shkrimet e tyre duhen marrun si të vërteta.

Pjeter Bogdani (1627 – 1689)

Në qoftë se Lufta e Kelmendit ndodhi në vitin 1640, në atë kohë, ky autor ishte rreth 13 dhe, me gjasë, jetonte në *Gur të Bardhë* të Hasit. Prandaj, nevojitet një studim i burimeve që ai përdori për tekstin e tij.

Në veprën e tij *Banda e Profetëve*, Bogdani shkruan:

“Kush mundet me i ram mbob se mǎ i vobek kje Vuça Pasha, i sill per të mbëledhë një ushtri dymbëdhëtë mi vetësh, nuk i mastuen shum

miljon ar, se Kelmendsit, të sijt me një za: “Eja kush ansht trim”, mbledhunë afer pesqind vetë, vrën Vuça Pashen, vjetit së Krishtit 1630. E në nevojë mpsuen me granë lëkuren e qarrit, posi të begatët majen e miellit, endë atyne ajo gjellë më shije u ka, se Pashallarvet e Sanxhakvet mishi i kingjavet e vjetave të njomë, pa ndiem kurraj të ngimë, tue ngrënë per gjith horë e tue votë rreth neper rajë të tyne, posi tha Profeta: “Kanë me ardhunë rreth gjytetsë e kanë me pësueu ûni posi qënt e gjithëherë më fort dëshërojnë”.

Arcangelo da Salto (Shekulli i 17^{të})

Ky teolog italian, në vëllimin e II^{të} të veprës së tij, *Vita del Venerabile Padre Fr. Bonaventura da Palazzuolo Riformato* (Venecia, 1722), jep detaje rreth luftës midis Kelmendit dhe Perandorisë Otomane.

“Vjetin 1638 dau Sulltani me mposhtë të Krishtënët të quejtn Kelmen, banorë të maleve të nalta të Shqypnis, shka s’i kishte dalë me bā qëse kishte pushtue at mbretni. Shënjoji per at qellim Pashen e Bosnjes me një ushtrī tridhetë mi luftarësh me të cillt shkojshin perdhuni edhe shum të Krishtënë. Ndeshtë të dyja ushtrit në shoshoqen me gjithse Kelmendsit s’ishin veçse shtatëqind, të ndimueu prej vendit të thyeshem, mbyten katermi Turq, mueren nozull e municjone, e ushtria qi pështoi u vu në të hikun e kjenë të ngushtuem me e shgrebë luften. Prej Kelmendsve mbeten vetem trembëdhjetë të dekun e disa të varruem, e prej të Krishtenve qi ishin kenë me Turq mbeten dekun tre a kater”.

François Lenormant (1837 - 1883)

Turcs et Monténégriens (Paris, 1866). Autori e shkroi tekstin e tij gjatë udhëtimit të tij në Ballkan, por me gjasë pjesa që flet për Luftën e Kelmendit u pat cituom prej da Saltos.

Në titullin e tekstit të tij, fjala ‘turk’ duhet marrun si musliman, jo si person i etnicitetit turk.

“Tuj e dijt qeverija otomane se çerdhja e anmiquve të sajë ishte Kelmendi, i dha urdhen në vjetë 1624 Pashës së Pejës e Mydyrrit të Gucis me e shtrue e me e bā të pakênun at fîs. Kta mbas urdhnit qi paten i msÿn,

po kjenë dā me dam e mbarre të madhe. Po per me muejt me e hjekë at kore prej vedit mueren e dhanë deri sa te e vona i a mbushen menden Stambollës me çue ndima të mdhā e ushtrī per me pushtue at fis, qi i qitëte aq trazime qeveris. Kshtu Pasha i Shkodres muer urdhen me e bashkue fuqin e vet me fuqi të Pashës së Boznjes e të Pejës e me e msý Kelmendin. Ushtria e bashkueme mbrrijti në tridhetë mi vetë edhe u nis prej Shkodret e u kap lugut të Cemit perpjetë. Kelmendsit u rrudhen perpjetë para gjith asajë mori ushtrie. Pa mbrrijt në Tamare, ku pigen Cemi i Selcës e Cemi i Vuklit, e ku Kelmendt kishin rrenue uren, banë një dredhi. U vînë në të hikun pa bā asnjë qindresë me randsi. Kjo ligshiti e dukshme u dha zemer Turqve e filluen me u shperda tuj e kalue lumin në kambë e tuj i ndjekë Kelmendsit majeve ku u shternguen per qindresë. Para se me i a nisë ktij sulmit Kelmendsit kishin çue një rrem ushtrie mbrapa Turqve tinzë, e kshtū pa pritë pa kujtue kjenë të msým prej të dyja anve. Kelmendt të ndimuem edhe prej grave të veta rrokulluen shkamij e shkrepā mbi Turq, të cilt ishin shperda lugut të Cemit e brijave, por shumica gindeshin në një grykë të ngushtë, ku s'muejshin me u sjellë. Me i msý para nuk muejshin, pse ndesheshin në trup t'ushtris së Kelmendit, sidomos në shkrepā e shkamij, qi u rrokullojshin në ta, kshtuqi s'u mbet tjetër veç me i çilë shteg vedit per mbrapa, shka nuk u duel ndryshej veç tuj bā të bjerruna të mdhā. Prej Turqve mbeten dekun gjasht mi vetë, megjithse nuk kjenë veç nandqind Kelmen, qi përbājshin gjith fuqin e tyne. Pasha i Boznjes kje i pari, qi u vu në të hikun.

Enrico de Gubernatis (1836 – 1914)

Edhe ky autor ka gjasë që citon da Salton. Mā poshtë jepen citimet e tij në italisht dhe përkthimet në shqip prej Marin Sirdanit.

Kelmendsit si per natyrë e vend të fortë, si per trimni qi tregojn xëhen per mā të rrebtit nder Shqyptarë (*... tum propter naturae et loci, munimen, tum ob propriam magnanimitatem sup rā, omnes Albanenses reputantur*).

Per shkak të disa të thyemeve t'ushtris turke e pse s'kishin muejt kurr me e shtrure at vend kishin fitue një nam të madh n'anekand

mbretnín otomane (*in toto ottomanico dominio magni nominis facti fuerant*).

Marin Sirdani (1885 – 1962)

Në pjesën që pason, Marin Sirdani formulon asertën e tij rreth Norës dhe Luftës së Kelmendit. Ai bazohet në citimet primare të dy shkollarëve, Bogdanit e da Saltos, citimet sekondare të Lenromantit e Gubernatis, dhe në dy intervista që i u bani dy Lekëve. Në vetvete, ky është punimi kërkimor original sirdanik, një qasje eklektike ku faktet historike e legjendat funksionojnë si kontrolle e balanca ndaj njëna-tjetrës. Çaku i punimeve të tilla nuk është as me argëtua masat as me e teprua me skajime shkencore, por me ndërtua një kuptim që mbështetet edhe në nevojat shpirtnore të popullit edhe në kërkesat e historiografisë. Duke mos anua as kah legjendat as kah historiografia, punimi përpiqet mos me e reduktua natyrën njerzore në argumente të thjeshta shkencore, logjike, a psikologjike; as mos me e teprua me skajime emocionale si ato të disa legjendave. Një punim i tillë ka edhe një vlerë të tretë: ai kundërshton teoritë konspirative a tribaliste.

Ndër shumë pashallarë që i lanë një ëmen të zi vedit në Shqypnin e Verit për barbarizëm e mizori njehet edhe një farë Vuçi Pashet. Mbasi ky nier i mbrapshtë me një ushtri të madhe turke i rā kryq e terthuer Kosovës mbarë, tuj bā shka i shkojte neper mend; bā at krahinë për shkop, mësyni Kelmendin, fisin mā të fortin e asajë kohe.

Bashkue një mori ushtrijet niset ky prej Shkodret, e tuj kalue neper Shkrel, Kastrat, e Rapshë të Hotit, bjen në Grabom.

Breg-Gjakësi

Kushtrimue, Kelmendi betohet më shtatë e shtatdhetë, jo vetem burrat por edhe grāt, mos me i rā turkut⁸ në dorë për sē gjalli. Një tubë sish aty për aty me të leta u turren e u ndeshen me terbm

⁸ turk – Me këtë term shenjohehin të gjithë ballkanasit që kishin konvertuom në fenë muslimane. Fishta bante një dallim të hollë: turqit e dinit: shqiptarët që kishin konvertuom në fenë islame; turqit – banorët e lindjes, p.sh., turqit, arabët, etj.

n'anmik më një lug, ku u derdh gjak i pamasë, e prandej që me atëherë e më sod i mbet ëmni Breg-gjakës.

Ngujimi në Qytezën e Kelmendit

Per ballë njëj anmiku tepër të madh, Kelmendsit nuk mujten me zatatë, por shkuen tuj luftue e tuj u smbrapë kadalas derisa ushtria anmike zotnoi dy lugjet e Kelmendit, e atëherë, lënë disa çeta të shperdame malesh, u ngujuen me rob e robí në Nikç, në vendin qi quhet “Gjytetza e Kelmendit”.

Shkretinimi i Kelmendit

N'egercim të dameve e të trazimeve qi patën prej Kelmendsve ushtria t'a pershkoi vendin tuj rroposë e tuj prishë gjithshkahin, kshtuqi në pak dit u banë ato vise si mos të kishte banue kurr rob i Zotit n'at dhë; shpijat zhdukë me themel, pemët pre per tokë, arnajët prishë, e deri ledhet e bashtinave dermue.

Pretimi mbë Ushtrinë Turke

Por para atij mjerimit Kelmendsit nuk ishin kurrkund të lodhun. Burra e grā bishin dita-me-ditë e nata-me-natë aty-ktu prej gerllatave e shkamive si të terbuem në çeta ushtarake e bājshin kërdi në ta.

Oferta e Anmikut

Tuj e pa Vuçi Pasha se me të keq ishte e kotë me shtruve at fis të fortë, mendoj me e thye me premtime. U çoi prandej lajmin se mbrenda njëj javet kushdo, burrë a grue, do t'u dorzojte, jo vetem ishte i falun per shkado kishte bā, por edhe do t'i shpërblehej dāmi qi kishte pasë per shkak t'asajë lufte.

Kuvendi

Mbërrijti lajmi i Pashës te Gjyteza e Kelmendit ku ishte fuqija ma e madhja e tyne, u mblodhën në kuvend, e mbasi nuk i shkojte asnjani as neper mend me u dorzue me gjithse kishte hipë një zi aq

e madhe buke sa me u mbajtë i lum aj qi muejte me u ngi me lkura ahi, persriten ben qi kishin pasë ba kur nisi lufta: mos me i ra per së gjallit Turkut në dorë; e posë kësajë, perforcuen edhe ndeshkimin e zakonshem të tyne, me ba batate kedo që guzonte me ba spionazhë a me tradhtue vendin.

Besa

Me burra, n'at mbledhe, ishin edhe një numer i mirë grash e varzash qi ma se një herë kishin ra në luftë e ishin da me nderë. Një nder to, emnit Nore, e bija e njëj kryetarit, vajzë kund një njëzet vjeçe, e bashme, e lidhme, e me një bukuri të jashtzakonshme, e quejtun prandej edhe Nora e Bukur, lypë leje me folë. Xjerrë at lëje, u thotë se po kje se e kishte fatin me u ndeshë vetem per vetem me të, do t'i a merrte jeten.

I ati, i cili ndollte aty në mbledhje, i dha patjeter bekimin, veç i tha të mendohej mirë para se me ba at hap e me këtheje me nderë a me dekë me nderë. E prekun vajza prej atyne fjalve i pergjegjë t'et faqe gjith atij burri: “Se si ka me mbarue jeta e eme, lum baba, veç Zoti e din. Ndoshta Vuçi Pasha asht jetëgjatë e jetëgjati nuk bahet jetëshkurtë, por per veti di me thënë se qe besa e Zotit, un po shkoj e virgjën edhe do të këthej e virgjin a por do të des e virgjin”.

Në sa kjo po flitëte, krenët i lshojn sýt shoqishoqit, e mbasi e dishin per fort të virtytshme e e kishin pa disa herë me ra në luftë me ta e me u pré me Turq si ma i miri djaloç, ke mendojshin se edhe bukurija e sajë do t'i ndimojte me u ndeshë vetem per vetem me at Pashë, të tanë një zānit, si të marrun vesht, i thonë: “T'a priftë Zoti mbarë, o sokoleshë!”

Me kaq kuvendi dahet, e kush shpresojte në vepren e sajë, tjerët mjerojshin per rrezik ma fort të nderës se të jetës së sajë.

Nora nuk u hutue, por marrë ngrykë t'an e ma t'afermit e vet, 'veshet, mathet e kapistallet, e shtin një kurtjel në postavë, dhe drejtohet fill e te Pasha.

Vrasja e Vuçi Pashës

Roja tuj pasë urdhnin mos me i thënë kujë gjã po deshti me u dorzue, dhe mbasi Nora tha se ishte e çueme prej krenve me u marrë vesht me Pashën per punën e dorzimit, s'i bani fije pengimit, kështuqi mbriji në Tamaré, ku ishte qandra e ushtris, pa i hi ferrë në kambë.

Lajmue Pasha se kush ishte e pse dojte me u pjekë më të, meiherë e grishë në shatorre të vet. Aty nisë kjo me e rrëjtë e me e kaçarrëjt mbi mendimin e krenve. Pasha, para sajë, kishte mbetë shtang prej gojëtaris e ma fort prej bukuris së sajë, e tuj e pã kjo se i a kishte marrë mendët e tretë krejt fillin, nxjerrë me të shpejtë kurtjelin prej postavet e t'ia a mshon dy-tri heresh lik në zemer, e pa e lanë me bã as-ih as-uh e len shakull per tokë.

Prehë kambët atëherë Nora e çan rrugës drejt kahë kishte ardhë, e roja ke e kishte pa pak orë perpara tuj kalue andej s'i bani fjalë, me mendue se ajo do t'ishte ndërmjetsja e Pashës me Kelmend.

Sulmi i Kelmendasve

Nuk vonoi shum e u përhap lajmi i vrasjes së Pashës, e ushtria u përzie si flokët e harapit, por heroina kishte kalue n'anë të t'vetve e kishte pshtue. Kelmendsit, tuj perfitue prej asajë rase të bukur, porsa rã muzgu, u lshuen si egercina, burra e grã, me brimë zãjesh e pushke, me krizëm e rrokollim shkrepath me të vojte mendja se po shembej toka. Ushtria tuj mos i dijtë manã vedit muer hikën, rrugë e pa rrugë, tuj lanë nozull e gjithshka pat. Në këtë pshtjellim disa çeta kelmende i ndoqen kambë per kambë tuj i damtue per së forti, disa u a grabiten rrugen e u xënë gryka e shtiqe e bënë rrenim në ta, tjerë rroklojshin shkambij e shkrepa kahë kalojshin lugjeve e

gerllatave e i bajshin me iu dhimbët gurit e drunit. Aq kerdí u bã n'ushtri të Turkut n'at luftë neper ato vende të thyeshme, sa me t'u dukë prrallë shka u diftojte per ta, e prandej atye e mbrapa mbet fjalë: "S'lufton Kelmendi, por lufton vendi".

Kjo luftë, mbas ktij, ndolli kahë mjedisi i dimnit të vjetit 1637, e shkaku pse mbeten aq pak të krishtenë, qi ishin n'ushtri turke, e ven pse tuj e dijt Kelmendsit se perdhuni kishin ardhë me luftue kundra tyne u lshuen zã të bájshin ndonji shêj per me i njoftë, e ashtu u ruejten mos me i damtue (Kontribut).

Diskutimi

Historianët e shkollarët mund të flasin edhe për Norën edhe për Luftën e Kelmendit, por ata përqendrohen kryesisht në të dytën sepse ajo i përshtatet më mirë qasjes shkencore. Tipikisht, historia lidhet me një bashkësi.

Edhe rrëfyesit e legjendave mund të flasin edhe për Norën edhe për Luftën e Kelmendit, por ata anojnë kah tregimi i Norës sepse ai i përshtatet më mirë qasjes emocionale. Tipikisht, legjendat lidhen me një njeri.

Pseudo-historianët mund ta reduktojnë historinë në një deklaratë të huazuome prej doktrinash psikologjike. Për shembull, ata mund të thonë që Gjergj Kastrioti luftoi vetëm për një gjë, që të uhamerrej ndaj Sulltanit. Kjo qasje është thjeshtsuese dhe jointeligjente edhe për një arsye të tjetër. Sulltani kishte një perandori të tanë me sundua. Si mund të argumentohet që ai u muar personalisht me një shqiptar që zotnonte një grusht katundesh e qytezash!?

Përfundimi

Sirdani len me kuptua që Nora dhe i jati i saj kishin marrdhanje shumë të mira, dhe që Nora vullnetohet me vrã pashën. Vendimi i saj ishte heroik sepse ajo vendosi me rezikua jetën e saj për hir të bashkësisë. Kjo bindje ndryshon prej legjendave, ku Nora ishte një

heroinë e një tipi tjetër; të asaj që vdes për hir të nderit. Kështu, vullnetimi pendsohet me nevojën për luftë çliruese, ndërsa nderi me nevojën për legjenda me tregua randsinë e nderit në një situatë kur ushtria pushtuese ishte ushtri përdhunuese.

Legjenda e Norës dhe Luftës, mund të lidhej vetëm me Kelmendin misterioz të asaj kohe, me Kelmenin që pretonte mbë ushtarët turq, karavanet turke, dhe prandaj tregimet e legjendat mund të ishin të besueshme. Nuk mund të besohej që legjenda të tilla mund të ndodhnin në zona urbane ku gratë trajtoheshin si robina, as në katundet e banuome prej vakufëve. Në shekullin e 17^{te}, Kelmendi ishte si Jutbina në hymje të shekullit të 20^{te}. Në fakt, *Eposi i Trimave* do të ishte më i besueshëm në Kelmendin e asaj kohe.

Kelmendi ishte i mbështjellun në muzg misterioz edhe për një arsye tjetër. Ndryshe prej ballkanasve të pushtuom, të cilët kishin konvertuom në fetë kristiane a muhamedane, Kelmendasit vazhdonin të besonin në *Zotënit e Parë*, ku Kryezoti ishte *Rrufeljdedhësi*, jo një divinitet që krenohej sepse ai bante kompromis me kërkesat e anmikut. Vene ré se sa pozitivisht përshkruheshin kelmendasit e asaj kohe prej historianëve e shkollarëve: *trima, mjeshtra lufte, të pasun, trupmëdhenj, të pashëm*; praktikisht Zotën.

Çashtje nuk është nëse këto përshkrime ishin të vërteta, por që në thellsinë e Avës⁹ së tyne psikologjike, ballkanasit zhigeshin për egzistencën e një popullsie të tillë; një popullsie që do ta zdriste Errsinës Ballkanike me zjarm e hekur të skuqun.

Referencat

Relazione mbi Gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në Shekullin XVII, Vëllimi II(1634-1650)

⁹ Avë – la. shpirt, arab. ymër (Gazulli, Dema, Topalli)

Relacion i Ipezhëkëvit të Sapës, Frang Bardhit, drejtue Kongregacionit të Pp. F. -- Mbi vizitën e kryeme në Spas, Iballe e Pult dhe mbi akspeditën e Vuço Pashës në Kelmend., faqe 117.

Pjetër Bogdani, *Cuneus Prophetarum*, 1685

Arcangelo da Salto, *Vita del Venerabile Padre Fr. Bonaventura da Palazzuolo Riformato*, 1722.

François Lenormant, *Turcs et Monténégrins*,

M. Sirdani, *Kontribut per Historine e Kulturen Shqiptare*, Libraria Françeskane, Shkodër, 2005.